




| | |
|---|------------------------|
| REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE | |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep: 2-D/DPK | Nr. Protok: 01-3834/12 |
| Nr. Strana: 02 | Dati: 24.10.2012 |
| Nr. faqes: 02 | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **03.10.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-4777-11, pa konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për ztr. Avdi Salihu – Dekan në Fakultetin e Shkencave Teknike në Mitrovicë, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e dëshmojnë ekzistimin e konflikti të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin me numër protokoli AKK-03-4777/11, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pas procedurës së shqyrtimit, kemi konstatuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konfliktit të interesit.

Është e vërtetë se zyrtari i lartë Avdi Salihu - Dekan në Fakultetin e Shkencave Teknike në Mitrovicë është edhe drejtues i Institutit "F.SH.T.A." sh.p.k. Kjo e drejtë i jepet atij për shkak se ky funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit që ka si Dekan (neni 16, pika 1, e Ligjit për Parandalimin e Konflikti të interesit , Nr.04/L-051)

Po ashtu nga informacionet e fundit që na i ka dërguar ztr. Salihu (DPK/DPKI-03-3515/12) kemi kuptuar se ai tashmë nuk është Dekan i këtij fakulteti.

Në bazë të këtijë dokumenti zyrtar, dhe Ligjit për parandalimin e konflikti të interesit (Nr.04/L-051) kemi konstatuar se nuk ka situatë të konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

